Organization for Security and Co-operation in Europe
OSCE Mission in Kosovo

Edukimi i fëmijëve për rreziqet nga zjarri

Zjarret në Kosovë rrezikojnë fëmijët më shumë se të gjitha grup-moshat tjera. Prandaj me anë të një projekti i cili do të prezantohet në të gjitha shkollat fillore të Kosovës, OSBE bën përpjekje për vetëdijesimin e fëmijëve për mbrojtjen nga zjarri dhe parandalimin e tij.

Të ndihmohen më të rrezikuarit

Dera hapet dhe e gjithë klasa njëzëri përshëndet "Mirëdita"! Fëmijët të heshtur vështrojnë një njeri të moshës mesatare duke ecur drejt tavolinës së arsimtarit gjersa ai prezantohet. "Unë jam Bajram Rexhepi nga brigada e zjarrfikësve të Prishtinës".

Bajrami ka qene zjarrfikës për më tepër se 13 vite, por më 10 tetor 2008, ai ishte pak nervoz. Për herë të parë në jetën e tij, ai duhet t'ua shpjegojë një grupi nxënësish të moshës tetëvjeçare, atë që ata duhet të bëjnë në rast zjarri, apo si ta parandalojnë atë në rast se shfaqet. "Kam bërë shumë prezantime, por ky i sotmi është më ndryshe", thotë ai. "Duhet të shpjegojë çdo gjë në gjuhën që e kuptojnë fëmijët".

Sipas Bajramit numri i zjarreve në Kosovë është i lartë. Vetëm nga janari deri në shtator të këtij viti janë raportuar më tepër se 5,000 incidente zjarri, të cilët shkaktuan vdekjen e shtatë personave dhe qindra të tjerë të lënduar.

"Fatkeqësisht pjesa më e madhe e tyre janë fëmijë", thotë ai duke përkujtuar rastin e 6 tetorit, kur dy vajza të moshës dy dhe pesëvjeçare vdiqën nga një zjarr i shkaktuar në shtëpinë e tyre në fshatin Jezerc, komuna Ferizaj.

Rrethanat imponuese

Për shkak të incidenteve të tilla, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka nisur projekt edukimi për shkollat fillore, duke e angazhuar Asociacionin për mbrojtjen nga zjarri nga Prishtina për mbajtjen e ligjëratave.

Angela Tenbruck zyrtare për siguri, shpjegon se ligjëratat në shkolla janë vetëm një pjesë e përpjekjeve të Misionit të OSBE-së në vetëdijesimin e fëmijëve për rrezikun nga zjarri. "Ne, gjithashtu kemi ndihmuar shkollat duke shtypyr fletushka dhe shenja për dalje në rast rreziku", thotë ajo.

Meqë dimri po afrohet, ishte koha e duhur për ta nisur këtë projekt, shton Angela. Në këtë stinë ndërprerjet e energjisë elektrike janë më të shtuara, dhe si rezultat pritet që edhe zjarret të shkaktohen më tepër nga ndezja e qirinjve, gjeneratorëve dhe stufave me dru dhe gaz. "Fëmijët duhet të jenë të informuar për këtë rrezik", thotë ajo.

Kryesorja është Parandalimi

Projekti fillimisht do t'i përfshijë pesë shkolla fillore të regjionit të Prishtinës. Në vitin 2009 ligjëratat, fletushkat dhe shenjat do të shkojnë edhe në 541 shkolla fillore të Kosovës sa janë gjithsej. Si rezultat rreth 300,000 nëntëvjeçar do të jenë më të informuar dhe më të përgatitur.

Arbnor Hasani, koordinator i projektit nga Asociacioni për mbrojtjen nga zjarri, thotë se parandalimi është qenësor. "Ajo që kemi mësuar nga puna jonë, është se

shumë jetë njerëzish mund të shpëtohen nëse njerëzit dinë se si të reagojnë dhe të mbrohen nga zjarri".

Bajram Rexhepi shpjegon më tutje se në shumicën e rasteve fëmijët janë shkaktarë të zjarrit duke luajtur me shkrepëse. Të frikësuar nga prindërit e tyre, ata përpiqen ta shuajnë zjarrin vetë, në vend që të thërrasin për ndihmë. "Sa më tepër kohë që kalon, zjarri shkon duke u bërë gjithnjë e më i madh", thotë ai.

Mësimi për mbrojtjen nga zjarri

Për t'ua shpjeguar fëmijëve rrezikun nga zjarri dhe si të mbrohen nga ai, duhet mbajtur përqendrimin e tyre për një kohë. Por, Bajrami është shumë i kënaqur me interesimin e shfaqur nga fëmijët: "Madje edhe nëse ata vetëm një gjë mbajnë mend nga prezantimi im, ja vlen".

Lisa Beqiri në klasën e tretë të shkollës fillore 'Dardania' në Prishtinë, është e lumtur që ajo dhe shokët e saj të klasës ishin të parët që dëgjuan ligjëratën e Bajramit. "Unë tani e di që në rast zjarri nuk duhet të fshehëm pas dere', thotë ajo. 'Unë duhet të vrapojë dhe të bërtas zjarr, zjarr!", shton Lisa duke qeshur.

Bajrami dhe dy kolegët e tij, që gjithashtu do të jenë ligjërues ditët në vijim, kanë një rrugë të gjatë përpara. Mirëpo, duke parë entuziazmin e fëmijëve, Bajrami është i sigurt se gjërat do të ndryshojnë për të mirë.

Ai beson se zgjidhje afatgjate është përfshirja e edukatës për sigurinë nga zjarri në plan-programet shkollore, ide që edhe është duke u diskutuar në mes të Misionit të OSBE-së, Asociacionit për mbrojtjen nga zjarri dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Autor: Hasan Sopa